



Prishtinë: 17.12.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1469\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2263\_11\_21** të dt. 15.11.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 26.11.2021;

në seancën e mbajtur më datë 17.12.2021 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHE**T si e pa bazuar ankesa e konsumatorit I. B., parashtruar nga R. B., nga Komuna e Fushë Kosovës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2263\_11\_21, i datës 15.11.2021.

## A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 15.11.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2263\_11\_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit I. B., nga Komuna e Fushë Kosovës, lidhur me kontestimin e korrigjimit të dt. 19.08.2020 dhe e ka obliguar KESCO-n që konsumatorit t'i ofroj një kontratë pagese prej tetëdhjetë e një (81) muajve.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori I. B., brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Konsumatori pretendon që e ka paguar borxhin, mirëpo jo edhe korrigjimin plotësues;
- Përgjegjësia për njehsorët jo të rregullt është e KEDS-it;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 17.11.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se ai e ka paguar borxhin, ZRrE thekson se, pasi ka analizuar me kujdes rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit, ka konstatuar se, lexuesi i KESD-it ka bërë lexime të rregullta mujore, por që në asnjë rast nuk ka evidentuar që njehsori elektrik nr.35001915 ka



bërë matje në katër tarifrat, por që vetëm në disa periudha ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve. ZRrE më tej duke pasur parasysh kWh e regjistruar ne tarifën T3 dhe T4 ka bere shpërndarjen e këtyre kWh për periudhën 03/2012 deri ne periudhën 11/2018, por qe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiarë. ZrRE konstaton se faturimi i konsumatorit për periudhën 03/2012 deri ne periudhën e ndërrimit te njehsorit nr. 35001951 është bere ne kundërshtim me nenin 5 paragrafin 1.5 te Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: “Të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifrat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”, andaj edhe konsumatorit duhet t’i ofrohet kontrate pagese për periudhën 81 mujore për vlerën e ngarkuar prej **+3,323.34€**.

Gjithashtu, ZRrE ka analizuar edhe Korrigjimin e dt. 19.08.2020, për çka ka konstatuar se Departamenti i faturimit në KESCO përmes korrigjimit nr. 95631DPR-90076159 , ka bërë korrigjimin plotësues në vlerë **+3,323.34€** duke u bazuar në procesverbalin e shqyrtimit detal të njehsorit elektrik Nr.Org.02 nr.89 datë 03.01.2019, faturim i kWh të tarifave T3 dhe T4 për periudhën 03/2012 deri ne periudhën 11/2018 ku ceket se njehsori elektrik ka vlerë të shpenzuar të energjisë elektrike në T3=36,133 dhe T4=20,674 , totali i kWh janë shpërndarë në T1 dhe T2 sipas proporcionit **65.45%** dhe **34.54%**, bazuar në shpenzimet me njehsorin e ri.

Bazuar ne te gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifrat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

ZRrE rithekson faktin se, pavarësisht se i licencuari KESCO nuk ka vepruar në harmoni me legjislacionin në fuqi, shpenzimi i regjistruar i energjisë elektrike nga konsumatori, si i tillë duhet të paguhet. Respektivisht, sipas procesverbalit të shqyrtimit të njehsorit elektrik të dt. 03.01.2019, të Qendrës së Kalibrimit, ka rezultuar se, njehsori elektrik ka vlerë të shpenzuar të energjisë elektrike në **T3=36,133.146 kWh** dhe në **T4=20,674.328 kWh**. Po ashtu është evidentuar se gabimi në matje i njehsorit elektrik nr. 35001915 është **+0.37%**, pra brenda kufijve të lejuar të matjes dhe rrjedhimisht, duke e marrë parasysh faktin që, konsumatori e ka shpenzuar këtë energji elektrike, ZRrE ka vlerësuar se, konsumatorit duhet t’i ofrohet kontratë pagese për vlerën e ngarkuar prej **+3,323.34€**, për periudhën 81 mujore.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRrE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit I. B. (R. B.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.